



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Kontrolli i Lartë i Shtetit shpall konkursin për vende të lira pune:

I. Për 1 (një) vend në pozicionin e Juristit/Specialistit në Drejtorinë e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Kërkesat për kandidatët e këtij vendi pune janë:

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jenë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Shkencor në Drejtësi.
- Të kenë eksperiencë pune mbi 12 vjet në aparatin e Kuvendit të Shqipërisë si specialist;
- Të zotërojnë një gjuhë të huaj të një prej vendeve të BE-së;
- Të zotërojnë programet bazë të kompjuterit, paketën MS Office, programin IDEA;
- Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese për të punuar në grup;

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

Përshkrimi i punës

Përgjigjet dhe jep llogari për veprimtarinë e tij përpara drejtorit të drejtorisë. Harton dhe i paraqet për miratim drejtorit të drejtorisë programet mujore e vjetore të punës. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtorisë ndjek dhe zbaton me rigorozitet dhe cilësi planin vjetor të botimeve të KLSH-së, të miratuar nga Kryetari. Bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve për përgatitjen e projekt marrëveshjeve të bashkëpunimit mes KLSH dhe SAI-ve të ndryshëm, të projekteve të binjakëzimit, etj., si dhe të programeve të zgjeruara të trajnimit për arritjen e misionit të Drejtorisë dhe të vetë KLSH-së, të cilat i paraqiten Kryetarit për miratim. Ndjek realizimin e strategjisë së bashkëpunimit dhe kooperimit të institucionit me INTOSAI, EUROSAI dhe SAI të vendeve të ndryshme, si dhe me institucione të tjera profesionale në fushën e auditimit; Ndjek botimet e stafit të KLSH-së në shtypin e përditshëm dhe harton informacione periodike për temat dhe përmbajtjen e tyre të cilat ia paraqet drejtorit të drejtorisë. Kryen detyra të tjera që i ngarkohen nga drejtori i drejtorisë, në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit. Koordinon veprimtarinë e KLSH me Kuvendin e Shqipërisë.

Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët duhet të paraqesin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore deri më datë 02 Dhjetor 2017 këto dokumente: Letër motivimi për aplikimin në vendin vakant, CV-në, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, kopje e listës së notave dhe librezës së punës të noterizuar, fotokopje e letërnjoftimit, rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaliteti, si dhe dokumente të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejnjë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale, si dhe dëshmi të dokumenteve ose jo të zotërimit të gjuhëve të huaja.

Konkurrimi

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civilë nëpërmjet procedurave të pranimit.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standardet e kontrollit të KLSH" dhe "Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, mbi njohuritë dhe të dhënat që jepen në serinë e botimeve të KLSH-së 2012-2016, si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së në internet". Provimi do të zhvillohet në gjuhën Shqip dhe Anglisht.

Në faqen zyrtare www.klsh.org.al sipas afateve të përcaktuara në ligj, më datë 05 Dhjetor 2017 do të shpallet edhe lista e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe data e zhvillimit të konkurrimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit